



Pranimi / Dërguar Prilazno / Podato Received / Delivered	18.07.2022	viti god year	2
Organ / Objekti Organ / Objekt	Dr. Prof. Dr. Prof. Prof. No.	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHK	4/187/2022		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.495/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga; Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Kocanëtar, si dhe Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës me numër A. Nr. 495/2022, të datës 02.06.2022, së ankuesit me adrese banimi rruga

kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nen paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 18.07.2022, mori këtë;

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A. Nr. 495/2022, e datës 02.06.2022, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi më datë 02.06.2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore, se pas shqyrtimit të aplikacioneve Komisioni për Grada dhe Disiplinë, i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ka rekomanduar për ankuesin gradën diplomatike Sekretar i tretë, me arsyetimin se garda nuk është dorëzuar asnjëherë dhe nuk është nënshkruar nga ish Ministria.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 09.06.2022, ka bërë kërkesë për përgjigjen në ankesë tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa më datë 17.06.2022, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ka dërguara përgjigje në ankesë tek Këshillit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike ,për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën e datës 14.04.2022, e parashtruar nga ankuesi me numër protokollit 3224/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 26.05.2022, me numër protokollit 323; Procesverbali i datës 08.12.2021, i Komisionit grada dhe Disiplinë; Akt Emërimi i datës 03.06.2020; Raporti i punës i Komisionit për grada dhe Disiplinë; Përgjigje në ankesë e datës 17.06.2022, me numër protokollit 3575/2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të gjithave shkresave të bashkëngjitura në lëndë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pa bazuar, sepse:

Komisioni për Grada dhe Disiplinë i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, pas shqyrtimit të aplikacionit të ankuesit me datë 28.09.2020, e ka rekomanduar në gradën diplomatike Sekretari i tretë, mirëpo nuk është nënshkruar nga Ministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pretendon që ministri të obligohet për të nënshkruar rekomandimin e Komisionit për Grada dhe Disiplinë dhe Sekretari të kalkuloj kohën e humbur nga rekomandimi i parë i komisionit për gradim.

Gjatë shqyrtimit të bazës ligjore konkretisht Ligjit Nr. 03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2009 për Shërbimin e Jashtëm të plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren QRK - Nr. 04/2014 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 02/2009 për Shërbimin e Jashtëm, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se është përgjegjësi diskrecionale e Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme që pas rekomandimit të Komisionit për Grada dhe Disiplinë të bëjë miratimin e tyre, mirëpo normat juridike në fuqi nuk kanë dhënë ndonjë afat ligjor se kur duhet të bëhet kjo, por vetëm është thënë që është në diskrecion të ministrit.

Bazuar në dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë çështjen e shërbimit të jashtëm, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson që nuk ka kompetencë të detyrojë Ministrin e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës të bëjë miratimin e rekomandimit të Komisionit për Grada dhe Disiplinë, andaj edhe pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, Prishtinë brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A nr. 495/2022

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Arkivit të KPMSHCK-së,